

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësi Ramë Hyseni, si kryetar i kolegjit, gjyqtarëve Fejzullah Rexhepi dhe Qerimi Ademi, xcsi anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit S.K., na Prizreni, kundër të paditurit Q.A., nga fshati ... Komuna e Suharekës, për shkak të pagesës së borxhit, duke vendosur sipas ankesës të paditurit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren, C.nr159/2008 i datës 10.11.2011, në seancën jo publike të mbajtur më dt. 23.09.2016, mori këtë

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e të paditurit Q.A., nga fashit ... Komuna e Suharekës, dhe **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prizren, C.nr.159/2008 i datës 10.11.2011.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar, në pikën I të dispozitivit është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe është detyruar i padituri që paditësit në emër të borxhit ti paguaj shumën prej 5.500 DM, të konvertuara në euro në ditën e pagesës në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit. Në pikën II të dispozitivit ka vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi, i padituri në afatin ligjor ka ushtruar ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoi ankesën si të bazuar ta ndryshoj aktgjykimin e atakuar, ashtu që t'ia refuzoi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazë, ose ta prishë aktgjykimin e atakuar dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar paditësi duke theksuar se pretendimet ankimore të paditurit janë të pabazuara, pasi që gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe në tërësi e ka vërtetuar gjendjen faktike, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta refuzoj ankesën si të pabazuar, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta vërtetoj në tërësi.

Pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar dhe shkresave të lëndës, në pajtim me nenin 194 të LPK Gjykata e Apelit e Kosovës, ka vërtetuar se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi S.K., nga Prizreni, ka ushtruar padi kundër të paditurit Q.A., nga fshati ... Komuna e Suharekës, për shkak të pagesës së borxhit me të dhëna si në petitumin e kërkesëpadisë si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata për ndriçimin e fakteve kontestuese në këtë çështje juridike, e duke vepruar sipas vërejtjeve të gjykatës së shkallës së dytë, në procedurën e provave ka bërë administrimin e provave përmes leximit të deklaratës të dëshmitares L.K. të dhënë në procesverbalin e datës 13.07.2006 dhe M.Z., të dhënë në procesverbalin e datës 11.11.2003 si dhe i ka dëgjuar palët ndërgjyqëse dhe pas vlerësimit të këtyre provave në kuptim të nenit 8 të LPK-së, dispozitës së nenit 324 par.1 të LMD-së dhe dispozitës së nenit 452 par.1 të LPK-së ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar me arsyetim se në mes të palëve ndërgjyqëse ka qenë kontestues fakti se a ia ka kthyer borxhin i padituri paditësit, të cilin borxh paditësi në vend të tij ia ka paguar të ndjerës M.Z., se i padituri në deklaratat e tija të dhëna para gjykatës nuk e ka kontestuar faktin se paditësi në vend të tij ia ka paguar borxhin kreditorit, ndërsa i padituri ka theksuar se këtë borxh nëpërmes dëshmitares Luljeta ia ka kthyer paditësit, e që nga kjo rrjedhë se i padituri ka pranuar borxhin që t'ia kthej paditësit, e jo të ndjerës M.Z., sepse e ka ditur faktin se borxhin në vend të tij ia ka paguar paditësi. Nga deklaratat e dëshmitares M.Z., gjykata ka vërtetuar faktin se ajo ka qenë në shtëpi kur shtatë vite pas luftës ka ardhur tek ajo S.K. dhe Q.A. të kërkojnë borxhe në shumë prej 7.000 DM, e që pas luftës asaj të hollat ia ka kthyer S.K. – paditësi në shumë prej 7.000 DM, kurse nga deklaratat e dëshmitares L.K. gjykata ka vërtetuar faktin se ajo ka qenë në marrëdhënie pune nga viti 1991 deri në vitin 1997 te i padituri dhe i njëjti ka pas nevojë për të holla, dhe e njëjta ka pranuar ti ndihmoj ashtu që e ka ftuar vëllain e saj S. i cili nuk ka pas të holla por të njëjtës i ka thënë se do t'ia gjejë të hollat për Q., ashtu që S. dhe Q. kanë shkuar së bashku në fshatin ... dhe nga një mik i tij R.Z., i kanë marrë 7.000 DM, duke theksuar e njëjta dëshmitare se ajo nuk ka qenë me ta, por ata i kanë thënë se i kanë marr këto të holla. Këto të holla nuk i janë kthyer S. i cili ka qenë garantues, por ka dëgjuar se Q. ka thënë se të hollat ia ka dhënë asaj që t'ia kthej S.-paditësit, duke theksuar se asaj Q. nuk i ka dhënë kurrfarë të hollash në lidhje me këtë borxh që ajo të ia epte S., por aq më tepër asaj nuk ia ka paguar edhe rogen e saj në tërësi çdo muaj, ashtu që e njëjta është dashur ta lëshoj punën. Nga provat e cekura – dëshmitarët e cekur më lartë gjykata ka ardhur në përfundim se paditësi për nevojat e të paditurit në cilësi të garantuesit i ka marr borxh te një mik i tij R.Z., në fshatin ... shumë prej 7.000 DM, të cilën shumë ia ka dhënë nëna e R.Z. - M.Z., të cilat të holla paditësi ia ka kthyer pas lufte në tërësi dëshmitares M.Z., ndërsa deri më tani i padituri paditësit nuk ia ka paguar borxhin në tërësi përveç shumës prej 750 € dhe atë sipas aktgjykimit të Gjykatës Komonale në Prizren C.nr.528/2002 të datës 11.11.2003, kurse paditësi pas luftës me disa tentime ka kërkuar nga Q. që

t'ia kthej borxhi por ai gjithnjë ka gjetë pretekst se borxhin do ta kthej, se nuk ka të holla dhe të ngjashme.

Kjo gjykatë, duke e vlerësuar përfundimin dhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë ka gjetur se i njëjti është i drejtë, i bazuar, se ka mbështetje në shkresat e lëndës dhe dispozitat ligjore, ndërkohë që janë dhënë edhe arsyet e justifikueshme të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Pretendimet ankimore të paditurit, kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara, pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore e as aplikim të gabuar të së drejtës materiale për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, ndërsa në bazë të provave të cekura më lartë gjykata në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, dhe lartësinë e borxhit për të cilin e ka obliguar të paditurin që të t'ia kthej paditësit.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 195.1 nën d) lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Ac.nr.244/2013 më dt. 23.09.2016

Kryetari i kolegjit,
Ramë Hyseni,

SHËNIM MBI VOTIM DHE VENDOSJE

Një zërit u vendos, në seancën jo publike të kolegjit të mbajtur më dt. 23.09.2016, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Referues ka qenë gjyqtari Ramë Hyseni.

Vërtetojnë:**Anëtarët e kolegjit****Kryetari i kolegjit**

1. _____

2. _____